



Pranuar / Dorezuar Prenjshëm / Prodato Received / Delivery	05 - 07 2022	viti god year	2
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3926/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.92/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Sabile Avdyli- Zyrtares e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.935/2019 të datës 16.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.92/2019 të datës 11.02.2019 të parashtruar nga ankuesja kundër

Vendimit me Nr. 04-052-141 të datës 29.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

PEZULLOHET procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.92/2019 e datës 11.02.2019, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Agjencia e Statistikave të Kosovës në bazë të autorizimit të datës 11.09.2018 lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike, me datë 13.09.2018 ka shpallur konkursin për pozitën “Zyrtar për Statistika të Investimeve”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja dhe është përfshirë në listën e ngushtë. Me datë 14.12.2018 Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka publikuar njoftimin me numër Nr. 04-052-2009 për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datë 14.12.2019, ka parashtruar ankesë me datë 14.01.2018 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, më datë 29.01.2019 nxjerr Vendim me numër Nr. 04-052-141, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të papabuar, duke lënë në fuqi shpalljen e publikimit të rezultateve.

Ankuesja kundër Vendimit me numër Nr. 04-052-141 të datës 29.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-

048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7590/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 13.02.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës. Agjencia e Statistikave të Kosovës më datë 19.02.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 27.03.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.935/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 27.03.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 11.02.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.06.2022 me numër të protokollit 3269/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.935/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokollit 714/2019; Vendimi me Nr.04-0452-141; Ankesën e datës 14.01.2019; E-mailin e datës 29.01.2019; E-mailin e datës 23.10.2018; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 14.12.2018; Konkursi i datës 13.09.2018; Njoftimin për vazhdimin e konkursit të datës 13.09.2018; Diploma e ankueses Nr.2423 e datës 05.07.2012; Letërnjoftimin e ankueses; Vërtetimin e datës 21.05.2018; Vërtetimin e datës 31.12.2017; Vërtetimin e datës 26.09.2014; Vërtetimin e datës 13.12.2018; Certifikatën e periudhës 10-21 dhjetor 2018; Certifikatën e datës 15.12.2018; Certifikatën e datës 23.06.2018; Certifikatën e muajit Tetor 2013; Certifikatën e datës 21.06.2018; Certifikatën e vitit 2017; Certifikatën e periudhës kohore 9-10 qershor 2012; Certifikatën e periudhës 13-31 gusht 2012; Letër rekomandimin e datës 28.12.2017; Referencën e datës 28.08.2012; Certifikatën e datës 14.11.2018; Certifikatën me nr.prot 62.II.Fat; Certifikatën me nr.prot Y3.II.Rre; Diplomën Nr.424 e datës 18.11.2013; Përgjigja ne kërkesë nga AKK me Nr.ref AKK-DPK-DPKI-03-02-2613/18; Vendimin nr.04-052-2028 i datës 14.12.2018; Raportin Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 14.12.2018; Njoftimin e datës 14.12.2018; Formularin Form. MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form. MAP-SHCK-11 i Raportit final të rekomandimit nga komisioni rekrutues; Lista e ngushtë e datës 12.10.2018; Formulari për të përcaktuar kriteret e zgjedhjes së ngushtë përfundimtare; Formularin Form. MAP-SHCK-04 i Regjistrit të aplikacioneve të pranuar; Formularin Form. MAP-SHCK-07 për Përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Propozimi për emërim i datës 5.10.2018; Vendimi për formimin e komisionit rekrutues i datës 26.09.2018; Deklarata Nr.04-052-1580 e datës 26.09.2018; Vendimin për zëvendësimin e anëtarit të komisionit rekrutues i datës 12.10.2018; Autorizimin nga DASHC/MAP i

datës 11.09.2018; Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit
 Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidates së
 përzgjedhur Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit
 Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit
 shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit Testi me
 shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit Testi me
 shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i
 kandidatit Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatit
 Kërkesa për punësim e ankueses me shkresat e lëndës; Kërkesa për punësim e
 kandidatës së përzgjedhur me shkresat e lëndës; Kërkesa për punësim e
 shkresat e lëndës; Formularin Form. MAP-SHCK-08 për vlerësimin individual të kandidatëve për
 vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin e përzgjedhur dhe
 kandidatët e tjerë që kanë kaluar testin me shkrim; Akt emërimet e pesë (5) anëtarëve të Komisionit
 Përzgjedhës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.92/2019 e datës 11.02.2019 e parashtruar nga ankuesja të **pezullohet, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.935/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 16.05.2022 ka shqyrtuar lëndën e ankueses sipas ankesës me numër A.nr.92/2019 të datës 11.02.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo për të njëjtin objekt shqyrtimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, janë pranuar prova shtese lidhur me ankesën me numër të protokollit 876/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit me numër 04-052-159 të datës 01.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, konkretisht ankuesja ka parashtruar kërkesë për Opinion në Agjencinë Kundër Korrupsionit lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit me Kryeshëfën Ekzekutiv të atëhershëm të ASK-së, sepse pasi që është rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit si kandidate e suksesshme për pozitën "Zyrtare për Statistika të Investimeve", Kryeshëfi Ekzekutiv i Agjencisë të Statistikave të Kosovës, me datë 19.12.2018 merr vendimin me numër 04-052-2028 me të cilin vendim e anulon raportin e rekomandimit të datës 25.10.2018 dhe emëron kandidaten e dyta me radhë me vlerësim nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit, sipas Opinioneve zyrtar-rekomandimit të datës 05.12.2018 të Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me situatën e konfliktit të interesit respektivisht lidhjes familjare të kandidates së përzgjedhur me Kryeshëfën Ekzekutiv të ASK-së.

Meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, për të njëjtin çështje ka pranuar prova shtese respektivisht kërkesën e datës 14.06.2022, drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit nga ankuesja lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit me Kryeshëfën Ekzekutiv të atëhershëm të ASK-së, dhe përderisa është vërtetuar se kërkesa është duke u trajtuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, Kolegji konstaton se në bazë të dispozitave ligjore të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "**Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të**

njoftojë palën për vendimin e pezullimit”, ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që shqyrtimi i lëndës A.nr.92/2019 të pezullohet deri në përgjigjen gjegjësisht ofrimin e opinionit zyrtar nga Agjencia Kundër Korrupsion lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 14.06.2022, të parashtruar nga ankuesja lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit me Kryeshefin ekzekutiv të atëhershëm të ASK-së, pasi që shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pas ofrimit të përgjigjes respektivisht opinionit zyrtar nga Agjencia Kundër Korrupsion lidhur me kërkesën e datës 14.06.2022, të parashtruar nga ankuesja me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit me Kryeshefin ekzekutiv të atëhershëm të ASK-së, do të vendos edhe për lëndën A.nr.92/2019 të ankueses


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nënit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.92/2019;

Sabile Avdyli



Zyrtare are e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë të Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

